



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**  
**Departamenti i Biologjisë**

**Hajrije Morina Berisha**

Titulli i punimit:

**LLOJET BIMORE TË VLERËSUARA NË LIBRIN E KUQ TË  
FLORËS VASKULARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PREZENTE NË PELLGUN E LUMIT MIRUSHË**

Punim i Masterit

Prishtinë, 2025



**UNIVERSITY OF PRISHTINA**  
**FACULTY OF MATHEMATICAL-NATURAL SCIENCES**  
**Department of Biology**

Candidate:  
**Hajrije Morina Berisha**

Title:  
**Plant species assessed in the Red Book of the Vascular Flora of the  
Republic of Kosovo present in the Mirusha River Basin**

Master Thesis

Prishtinë, 2025



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMETIKE-NATYRORE**  
**Departamenti i Biologjisë**

Kandidat:  
**Hajrije Morina Berisha**

Titulli i punimit:  
**Llojet bimore të vlerësuara në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të  
Republikës së Kosovës prezente në Pellgun e lumit Mirushë**

Punim i Masterit

Mentor:  
**Prof. Dr. Elez Krasniqi**

Prishtinë, 2025

## II. REZYME

Në tërësinë e Gadishullit Ballkanik, Kosova ka pozitë pothuajse qendrore. Me elemente e saj gjeografike, ajo padyshim se është hapësirë e individualizuar dhe specifike (Çavolli, R. 1997).

Si territor i vendosur brenda në kontinent, por jo shumë larg derave, paraqet territor me biodiversitet të pasur, në veçanti me florë dhe vegjetacion të pasur dhe interesant (Rexhepi, F., 1994, 2007).

Pellgui lumit Mirushë sipas gjeomorfologjisë është i ndryshëm dhe mjaftë dinamik. Kjo është e rëndësishme në formimin e ekosistemeve të ndryshme.

Pellgu i lartëpërmendur shtrihet ndërmjet Rrafshit të Dukagjinit dhe atij të Kosovës, duke përbërë një zone kalimtare me tipare të ndërthurrura të relievit kodrinor dhe atij malor.

Pellgu i Lumit Mirushë përbën një njësi natyrore me rëndësi të veçantë ekologjike dhe floristike në pjesën qendrore të rajonit të Llapushës, ndërmjet Rrafshit të Dukagjinit në perëndim dhe Rrafshit të Kosovës në lindje. Ky pellg shtrihet përgjatë rrjedhës së Lumit Mirushë, i cili rrjedh përgjatë pellgut dhe derdhet në lumin Drini i Bardhë. Nga banoret vendas- autoktone Llapusha është quajtur GROPA (territori me gropa) sepse përbehet nga një numër i konsideruar hurdhash që në popull njihen si gropa (Zogaj, I. 2010).

Territori i Pellgut karakterizohet nga relievi kodrinor-malor, me gjeologji dhe pedologji të ndryshme. Në bazë të Hartës Pedologjike të Kosovës (Pavicevic, N. et al. 1974), poashtu edhe sipas autorëve tjerë (Çavolli, R. 1997), përshkruhet prezenca e tokave aluviale si dhe tokave të kafenjta mesatare, të zhvilluara mbi depozitime gelqerore dhe materiale fluvioglaciale. Në zonat me të larta hasen rezinet dhe kambisolet me përmbajtje të larta gelqerore dhe pjellori të moderuar.

Klima është kontinentale, me verëra të nxehta, dimra të ftohta me reshje të moderuara. Në hartën e të reshurave dhe temperaturave të ajrit, reshjet vjetore në zone janë rreth 700 (758) mm përdërisa zona gjendet në izolimin mesatare vjetore të temperaturave të ajrit prej 10 (10.6) °C

Në tërësinë e vlerave të trashëgimisë natyrore të Pellgut të Lumit Mirushë ,vend me rëndësi kanë llojet bimore të vlerësuar në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës.

Rrjedha e lumit Mirushë, përfshirë edhe zonën ku është realizuar ky hulumtim, i takon zonave të mbrojtura me ligj (MMPH-AMMK 2010, MMPHI-AKMM 2023). Prandaj, kjo zonë duhet të konsiderohet specifikisht për shkak të ndikimeve negative antropogjene.

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i llojeve të bimëve vaskulare që gjenden në Pellgun e Lumit Mirushë dhe që përfshihen në Librin e Kuq të Florës vaskulare të Kosovës me qëllim të vlerësimit dhe krahasimit të gjendjes pas vlerësimit paraprak të vitit 2013.

Rëndësia e hulumtimit qëndron në kontributin për ruajtjen e fitodiversitetit të Kosovës si dhe në pasurimin e bazës së të dhënave për florën e Kosovës, informacione këto të vlefshme për institucionet mjedisore dhe shkencore në nivel vendi dhe më gjerë.

Në zonën e Pellgut të Mirushes është dukshme nderhyrja e paqendrueshme njerëzore, e që manifestohet si shfrytëzim i tokës për bujqësi, ndertime infrastrukturore dhe nxjerrje e materialeve ndërtimore

Ka ndërhyrje në shtratit e lumit dhe prerje ilegale të pyjeve të cilat kanë ndikuar në ekuilibrin ekologjik të zones. Kjo situatë kërkon ndermarjen e masave mbrojtëse me qëllim të ruajtjes së ekosistemeve.

Flora dhe vegjetacioni në Pellgun e Lumit Mirushë përfaqësojnë një mozaik të pasur të llojeve dhe bashkësive bimore, si rezultat i ndikimit të kushteve gjeografike respektivisht klimatike dhe gjeologjike të zonës.

Pyjet përfaqësohen kryesisht nga pyjet gjetheerënëse me dominim të pyjeve të dushkut. Vegetacioni i kullosave i takon tipit të kullosave kodrinore-malore, ndërsa livadhet janë të tipit të livadheve të ultësirave. Përgjatë rrjedhave të përrenjve dhe lumit Mirushë shtrihet vegetacioni pyjor-shkurror i dominuar nga shelgjet dhe plepat si dhe vegetacioni ujor.

Këtë larmi të florës dhe vegetacionit padyshim se e pasuron prezenca e llojeve himore të vlerësuara në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës.

Llojet himore janë të analizuar bazuar në gjendjen në terren. Ato u takojnë grupeve të ndryshme sistematike në kuadër të florës vaskulare.

Bazuar në kriteret e IUCN, këto lloje u takojnë njërës nga kategorive si në vijim: CR- I Rrezikuar në mënyrë kritike, EN- I Rrezikuar, NT- Gati i rrezikuar, LC- Më pak i Rrezikuar. Këto lloje himore janë *Aristolochia merxmuelleri*, *Chamaecytisus purpureus*, *Lysimachia atropurpurea*, *Tulipa kosovarica*, *Adonis vernalis*, *Genista hassertiana*, *Gladiolus illyricus*, *Haplophyllum boissierianum*, *Knautia macedonica*, *Pinguicula crystallina* Sm. subsp. *hirtiflora*, *Sanguisorba albanica*, *Scutellaria orientalis*, *Aster albanicus*, *Centaurea albertii*, *Malus Florentina*, *Onosma echinoides* L. subsp. *javorkae*, *Paeonia peregrina*, *Paramolthia doerfleri*, *Potentilla visianii*, *Salvia ringens*, *Saponaria sicula* Rafin. subsp. *intermedia*, *Sedum serpentini*, *Veronica andrasovszkyi* Jav. [*V. spicata* L. subsp. *barrelieri* (Schott ex Roemer & Schultes) Murb.], *Centaurea kosaninii*, *Forzythia europaea*, *Halacsya sendtneri*, *Linum flavum*, *Polygala doerfleri*, *Scabiosa fumaroides*.

Nëse bëjmë krahasimin me studimin e këtyre llojeve në periudhën 2013-2025 nuk vërehen dallime shumë të theksuara. Kjo ndoshta rezulton nga lëvizjet demografike në dekadën sidomos pas zhvendosjes së popullatës rezidente të zonave nga fshatrat drejt vendeve më të urbanizuara (qyteteve apo qyteteve).

Bazuar në gjendjen në terren dhe potencialit të vlerave të trashëgimisë natyrore, sidomos të vlerave të mbrojtura me ligj, Pellgu i hamit Mirushë duhet të monitorohet nga organet kompetente me qëllim të ruajtjes së këtyre vlerave.